

FORÇA

E RE DEMOKRATIKE

PROGRAMI ELEKTORAL

i Qeverisjes së Komunës së Ulqinit

2018-2022

TA MBROJTMË TË ARDHMEN

voto 5

Përmbajtja

Qeverisja e mirë dhe decentralizimi i pushtetit	3
Turizmi.....	4
Bujqësia	7
Ekonomia, mbështetja për biznesin dhe punësimi	9
Rimëkëmbja urbane	9
Kultura dhe trashëgimia kulturore.....	10
Valdanosi, Kriporja dhe parqet.....	11
Shëndetësia.....	11
Kalaja	12
Shasi	12
Infrastruktura komunale	13
Deti dhe të mirat detare	16
Arsimi	17
Sporti dhe rekreacioni.....	18
Rinia	19
Gratë.....	19
Të moshuarit	20
Diaspora.....	21
Bashkëpunimi me shoqërinë civile	21
Ndërmarrjet Publike.....	21
Administrata	22

Programi dhe plani i mëposhtëm është i krijuar falë të dhënave dhe eksperiencës së grumbulluar gjatë viteve 2016-2017 dhe 2011-2013 kur FORCA ishte në pushtet në Komunën e Ulqinit, në bazë dokumenteve strategjike zhvillimore të Komunës, standardeve evropiane dhe interesave kombëtare.

Ky është plani që vendos administrimin lokal në një pozitë të re -- në atë të shërbëtorit të përkryer dhe partnerit besnik të qytetarit dhe në pozitën e një drejtuesi strategjik të qytetit që ka për qëllim që të vendosë në rrugë të shëndoshë dhe të drejtë zhvillimin e qytetit dhe jetën e qytetarit në të njëjtën kohë.

Programi është i hartuar në disa parime themeltare si vijojnë.

- Dinjitet për qytetarët, punonjësit, pensionistët, prindërit, fëmijët dhe studentët;
- Krijimi i klimës së investimeve që nuk prishin ekuilibrin natyror, ekonomik dhe, demografik.
- Transparencë dhe partneritet të plotë me qytetarin.

Këto do të arrihen nëpërmjet:

- modernizimit dhe digjitalizimit të mëtejshëm të shërbimeve të organeve të vetëqeverisjes lokale;
- realizimit të matshëm të arritjeve dhe progresit: do të krijohet metodologji transparente për përcjelljen e punës së organeve dhe do të jetë e lehtë të zbulohen pengesat, hallkat e dobëta dhe dërrasat e kalbura të administratës lokale.
- lidhshmëri të plotë: edhe pse shumë çështje që trajtohen në këtë program janë në ingerencë të pushtetit qendror, Komuna do të tentojë të bëjë me plotësimin dhe përmirësimin in e këtyre shërbimeve në mënyrë që qytetarët tanë të kenë jetë me dinjitet kurse mysafirët qëndrim të këndshëm.

Qeverisja e mirë dhe decentralizimi i pushtetit

FORCA e ka pasur dhe do ta ketë në vazhdim, një ndër prioritetet e saj thelbësore ngritjen e nivelit të decentralizimit dhe konsolidimin e vet-administrimit lokal të Komunës së Ulqinit. Për të realizuar sicc duhet detyrat e pushtetit vendor, FORCA mendon se nevojitet zgjerimi i kompetencave administrative dhe fiskale të Komunës së Ulqinit prandaj do të llobojë që ta realizojë këtë gjë. FORCA do të vazhdojë të vendosë në funksion të plotë ingerencat ekzistuese të Komunës së Ulqinit dhe të shfrytëzojë deri në maksimum hapësirën ligjore ekzistuese në Mal

të Zi për të siguruar sa më shumë vet-administrim të Komunës së Ulqinit. FORCA do të luftojë edhe më tutje kundër diskriminimit që i bëhet Komunës së Ulqinit lidhur me kompetencat, autoritetin e saj dhe investimet. Për të përmbushur këtë qëllim

Komuna e Ulqinit nën qeverisjen e FORCËS do të shndërrohet në një shembull të mirë në gjithë Malin e Zi në mënyrë që kjo komunë të fitojë më shumë besim për ta merituar dhënien e më shumë kompetencave. FORCA ka për të shfrytëzuar mbrojtjen ndërkombëtare ligjore për drejtat e pakicave për të mundësuar zgjerimin, avancimin dhe forcimin e ingerencave lokale të Komunës së Ulqinit. Ajo gjithashtu ka për të lobuar tek qeveria e Malit të Zi, si dhe tek aktorët ndërkombëtarë për të mundësuar synimet e sipërpërmendura. FORCA do të kërkojë mbështetje tek shumë mekanizma ndërkombëtarë lidhur me garantimin e maksimumit të vet-administrimit lokal në Komunën e Ulqinit janë:

Turizmi

Duke pasur parasysh faktin që ekonomia e çdo amvisërie është e lidhur ngushtë me turizmin, FORCA ka për pikësynim avancimin e turizmit të qëndrueshëm dhe elitare, sipas planeve strategjike të Komunës. Komuna do të krijojë dhe mirëmbajë këtë ekosistem zhvillimor për turizmin.

Programi jonë parashikon një seri hapash konkrete afatshkurta dhe afatgjata. Në parim, FORCA zotohet që të krijojë dhe mirëmbajë infrastrukturën urbane në shërbim të kësaj dege të ekonomisë duke e mbajtur gjithmonë një sy në estetikën dhe efikasitetin e zgjidhjes së ofruar. Në këtë fushë, shihet si e domosdoshme shërbimi falas i internetit në vendet më të frekuentuara: Kala, Ranë dhe plazhe. Kujdesi i Komunës për këtë degë të ekonomisë do të institucionalizohet edhe më tej me një organ të veçantë brenda strukturës organizative të Komunës. Kategorizimi i kapaciteteve të akomodimit privat është obligim ligjor dhe ky kapitull, i cili do të shkojë krah për krah me legalizimin e objekteve, do të rregullojë këtë treg duke eliminuar konkurrencën jo të ndershme, duke bërë nivelimin e natyrshëm të çmimeve që reflektojnë kualitetin, duke bërë eliminimin e dhomave të cilat nuk i plotësojnë kushtet nga oferta turistike e qytetit. Si rezultat, turistit i lehtësohet zgjedhja e akomodimit sipas preferencave të tija.

Së bashku me Organizatën Turistike, me ekspertë dhe me grupet e interesit do të krijohen produkte të reja turistike, itinerare të ndryshme që mbulojnë pika piktoreske të qytetit apo evenimente e koncerte të ndryshme. Një kujdes i veçantë do t'i kushtohet mbajtjes së disa festivaleve që valorizojnë vlerat autentike të traditës së lashtë të Ulqinit. Në veçanti, e shohim të domosdoshëm krijimin e shërbimit të Tour Bus, i cili është treguar si i domosdoshëm për një qytet të mirëfilltë turistik. Autobusët që përdoren në këto janë të hapur dhe ekologjikë dhe mund të përshkohen nëpër pothuajse të gjitha rrugët e Ulqinit. Itineraret që do të përshkohen do të studiohen paraprakisht.

Paketat dhe ofertat turistike që shiten më së shumti në tregun evropian janë të shkurta -- zakonisht 7 ditore. Shërbimi kualitativ i këtyre turistëve kërkon infrastrukturë rrugore të mirë dhe organizim të përkryer të muzeve, restoranteve, barkaxhinjve, ofruesve të shërbimeve të sporteve ekstreme, pikave kufitare etj. Komuna mund të mos ketë ndikim në të gjitha këto, por me anë të një bashkëpunimi të mirëfillte me personat fizikë, juridikë, me shoqata dhe institucione të ndryshme, organet komunale do të stimulojnë përmirësimin e këtyre shërbimeve dhe promovimin e tyre. Pra, edhe në këtë fushë, Komuna do të marrë rolin aktiv.

Dy vitet e fundit, shumë qiradhënës ofrojnë dhomat nëpërmjet booking.com, Airbnb dhe Expedia dhe kjo ka sjellë një numër të konsiderueshëm turistësh nga vendet më të ndryshme të botës. Për ta lehtësuar më tepër menaxhimin e plotë të kapaciteteve të veta dhe shitjen automatike, Komuna do të ofrojë falas programin e sofistikuar kompjuterik për të gjithë hotelet dhe pensionet e Ulqinit, i cili e automatizon shitjen e kapaciteteve në booking.com, airbnb dhe expedia. Organet e Komunës do të ofrojnë disa trajnime për punën me këtë program. Me këtë jo vetëm që do hapim dyert e tregut turistik botëror, por edhe do rrisim nivelin e shërbimit, duke mënjanuar mundësitë e gabimeve gjata rezervimit të dhomave dhe duke mos cenuar me kualitet dhe numra hotelet e mëdha të tashëm dhe atyre që do të ndërtohen në të ardhmen.

Synimi dhe qëllimi kryesor i FORCËS do të jetë që Ulqinin ta bëjë tërheqës për investitorët e huaj po aq sa është tërheqës edhe për vizitorët me qëllim të ndërtimit të hoteleve me 5 yje, duke mos cenuar ekuilibrat e natyrës dhe demografisë së qytetit. Masat që po merren aktualisht synojnë ta shndërrojnë atë në një sektor konkurrues në rajon

Me vazhdimin e qeverisjes lokale, Forca do të vazhdojë me strategjinë e saj të cilën e ka filluar para 4 viteve, dhe si pjese e kësaj strategjie, e cila njëkohësisht përmban investimet në nivelin lokal të cilët do të nxisin ardhjen e investitorëve të huaj, janë:

- Promovimi i ofertës turistike të Ulqinit, si pikësnyim kryesori i Forcës, duke vazhduar punën e mëtejshme në sferën e marketingut për promovimin dinjitoz të qytetit tonë.
- Investimi dhe zhvillimi i turizmit sportiv dhe aktiv – ndërtimin e qendrave sportive për sporte të ndryshëm që ti jepet mundësia sportistëve të bëjnë stërvitjen në terrenet tonë, promovimi i sporteve në natyrë që mundësojnë ardhjen e mysafirëve edhe jashtë sezonit veror siç janë gjuetia, çiklizmi, vëzhgimi i shpezëve, peshkimi etj, por edhe ngritjen në një nivel më të lartë mundësinë e turizmit aktiv për të cilin tashmë Ulqini është i njohur si një ndër top destinacionet më të mira dhe atë për Kite dhe Ëind Surf, lundrimi me vela, vozitja e kajakeve etj.
- Promovimi më i lartë i turizmit së kampingut interesimi i të cilit viteve te fundit është në rritje të dukshme, ku edhe Ulqini ofron të gjitha kushtet e një oferte të tillë turistike, duke bërë prezantimin në agjenci të ndryshme së bashku me afaristët tanë.
- Promovimi dhe investimi në turizmin shëndetësor duke nxitur ndërtimin e qendrave që mund të ofrojnë shërbime të ndryshme për njerëzit e të gjitha moshave, duke shfrytëzuar rërën e plazheve tona si dhe burimin e ujit sulfurik, për të cilët Ulqini është i njohur në të gjithë rajonin.
- Promovimi i turizmit kulturor për të cilin Ulqini ka një traditë shumëvjeçare, dhe atë duke mundësuar dhe rindërtuar disa monumente, duke bërë hulumtime të reja arkeologjike në disa zona të qytetit dhe nën ujë, pasuruar fondet muzeale dhe organizuar edhe më tepër manifestime dhe mbrëmje kulturore, duke bërë hapjen e disa dyqaneve që do bëjnë shitjen e suvenirave autentikë të vendit tonë, të promovojmë më tepër legjendat tona të njohura e mbi të gjitha atë mbi Servantesin dhe Dulcinean, organizimin e aktiviteteve dhe eventeve zbavitëse gjatë sezonit veror duke qëndruar gjithnjë në dispozicion të qytetarëve dhe turistëve.

- Promovimi i turizmit të konferencave duke ndërtuar dhe ofruar ambiente për mbajtjen e konferencave të ndryshme si një ndër mundësitë më të mira për nxitjen e ardhjes së grupeve jashtë sezonit veror.
- Zhvillimi i agro turizmit duke huazuar nga përvojat më të mira ndërkombëtare, në zonat piktoreske të Komunës së Ulqinit (si psh. Buzë Bunës e në Shas, Millë, Bojk..) për të bërë sa më të larmishme dhe të gjatë ofertën turistike të Komunës së Ulqinit.
- Promovimi dhe investimi në kuadrot që punojnë në sferën e turizmit duke i dërguar jashtë vendit në praktikë dhe mësim për lëmi të caktuara, në mënyrë që Ulqinit t ja kthejmë reputacionin e dikurshëm për punëtorët turistik.
- Zhvillimi dhe investimi në infrastrukturë që ka për qëllim shtimin e numrit të turistëve dhe njëkohësisht kënaqësinë dhe përshtypjet e tyre mbi vendin tonë, siç janë ndërtimin e pikave të vrojtimit në lokacione të përzgjedhura të qytetit, si në Shtegvashë, Valdanos, rutat për ecje në natyrë – hiking ne malin e Sumës, Kulla e Kaldraçit, Kroni Burës, Lipojë, kroni i Begut, zbukurime të ndryshme të qytetit etj.

Së fundmi, praktika ndërkombëtare në këtë fushë e ka treguar të domosdoshme që të krijohet brendi i Ulqinit.

Bujqësia

Komuna e Ulqinit ka një potencial të jashtëzakonshëm për zhvillimin e bujqësisë. Planet strategjike të Malit të Zi kanë krijuar kornizat e zhvillimit të bujqësisë në Mal të Zi dhe për këtë, ka vënë në dispozicion edhe masa subvencionimi për bujqit.

Në periudhën e kaluar, komuna, mu sikur që ka ndarë buxhet për OJQ-të e sportin, ka ndarë një pjesë të buxhetit të vet për zhvillimin e bujqësisë, por këto fonde rëndom kanë mbetur të papërdorura.

FORCA fillimisht do të marrë masat për të rritur kapacitetin e vet administrativ për t'u marrë me këtë sektor të rëndësishëm të ekonomisë së Ulqinit në formën e një organi të veçantë që do të merret me administrimin dhe rritjen ekonomike në këtë fushë. E pajisur me këtë potencial ekspertësh, Komuna do të edukojë dhe asistojë bujqit për aplikimin për fondet të dedikuara për bujqësinë, për masat agroteknike që duhet ndërmarrë në kohët e caktuara dhe për teknologjitë e reja që mund të përdoren.

Në veçanti, FORCA do të stimulojë themelimin e një pike grumbullimi dhe magazinimi të produkteve bujqësore si dhe punishteve për tharjen e firqe, domateve e pemëve të tjera, konservimin e ullinjve, përpunimin e domateve dhe perimeve të tjera. Plani Hapësinor i sapo miratuar e parasheh Krythën e Katërkollës si lokalitet strategjik për këtë.

Gjatë procesit të adoptimit të normave evropiane në bujqësi, disa nga masat administrative të reja do të prekin bujqësinë edhe në prodhim edhe në shitje dhe Komuna në këtë do të marrë rolin e asistentit dhe edukuesit.

Ullishtaria është një nga degët e bujqësisë e cila është pjesë e identitetit të qytetit dhe për këtë FORCA do të nxisë zhvillimin e mëtejshëm të ullishtarisë duke stimuluar rritjen e prodhimtarisë, rritjen e kualitetit dhe zgjerimin e produkteve të ullirit.

Duke respektuar normat e veçanta të kultivimit të bimëve, krijohet një ekosistem natyror i pasur për prodhim të mjaltit dhe prodhimeve të bulmetit dhe mishit cilësor. Për këtë, blegtorisë dhe bletarisë do t'i kushtohet vëmendje e veçantë. FORCA do t'i kushtojë një vëmendje të veçantë brendimit dhe mbrojtjes të prodhimit vendor.

Meqë tokat bujqësore në Ulqin janë të ndara në parcela të vogla, duhet studiuar mundësia për zgjerimin e prodhimtarisë gjatë sezoneve të ftohta. Në veçanti flasim këtu para së gjithash për kultivimin e bimëve në sera.

Ekonomia, mbështetja për biznesin dhe punësimi

Forca ka për synim krijimin e një ekosistemi të vërtetë për jetë dinjitoze, për tërheqje të investimeve, për zhvillim të mirëfilltë të turizmit dhe bujqësisë. Për më tepër, përveç kësaj infrastrukture për zhvillimin e afarizmit në qytet, do të nxitet inkubimi dhe mbështetja e bizneseve të reja inovative duke krijuar një program të vërtetë stimulimi dhe mbështetjeje për këtë fushë. Përkujdesja jonë për biznesin do të jetë konstante: rritja ekonomike do të përcillet në mënyrë konstante dhe përgjigja institucionale e Komunës do të jetë përherë në shërbim të stimulimit të afarizmit dhe mirëqenies së qytetarëve njëkohësisht.

Një zyre e veçantë brenda Komunës do të marrë sipër që sipërmarrësit vendas të njoftohen mirë për mundësitë e kreditimit dhe lehtësirat e tjera për bizneset që ofrohen ose nga Fondi për Zhvillim dhe Investime i Malit të Zi, organeve republikane, bankave dhe fondeve ndërkombëtare. Komuna do të vazhdojë praksën e mirë e themeluar nga Forca për të trajnuar bizneset për hartimin e aplikimeve dhe planeve të biznesit. Masat që kemi propozuar më lart, krijojnë një klimë të volitshme për punësim afatgjatë dhe jo punësime të dhunshme që medoemos e dëmtojnë dhe rëndojnë ekonominë e qytetit.

Rimëkëmbja urbane

Ulqini është i vetmi qytet në bregdetin e Malit të Zi që nuk ka linja autobusi urban dhe ndër urban. Për këtë, FORCA do të planifikojë vënien në funksion të së paku dy linjave të autobusëve që do të lidhë Ulqinin me Adën dhe Ulqinin me Anë të Malit me orare dhe itinerare të planifikuara në bazë të nevojave që duhet të studiohen. Me këtë do të minimizohet përdorimi i veturave personale nga vendasit dhe mundësohet mobiliteti i turistëve.

Do të shtohen parqet së bashku me këndet e lojërave për fëmijë dhe terreneve sportive për rininë në tërë territorin dhe do të hapen dhe lirohen trotualet për këmbësorët. Me pozicionin e arkitektit të qytetit, si personit të dedikuar për t'u kujdesur për estetikën dhe efikasitetin e qytetit, do të lehtësohet implementimi i detyrimit tonë që të luftohet shëmtia dhe të mbrohen autenticiteti dhe specifikat arkitektonike autentike të Ulqinit.

Kultura dhe trashëgimia kulturore

FORCA zotohet për mbrojtje pro aktive e trashëgimisë materiale dhe jo materiale kulturore nëpërmjet ndërmarrjeve të saj publike nga kjo lëmi, organeve republikane, individëve, organizatave joqeveritare dhe organizatave ndërkombëtare.

FORCA zotohet që Komuna të marrë rolin e nxitësit të kësaj veprimtarie e jo të pritësit. Në veçanti, do të nxisë inventarizimin e trashëgimisë materiale dhe jo materiale në territorin e Komunës së Ulqinit dhe të nxisë marrjen e hapave konkrete për ruajtjen, ekspozimin dhe valorizimin e tyre nëpërmjet muzeve të Ulqinit, botimeve e festivaleve. Një përkujdesje e veçantë do t'i kushtohet rimëkëmbjes dhe mbrojtjes së lokalitetit arkeologjik të Shasit, institucionalizimi i këtij lokaliteti brenda institucioneve muzeale të qytetit dhe hapja e tij për vizitorë.

Do të revitalizohen edhe krojet e monumentet e tjera nga periudha osmane, me çka do të kompletohet njëra nga shtresat e trashëgimisë sonë kulturore për vizitorët. Do të stimulohen studimet dhe hulumtimet mbi të shkuarën e qytetit. Një pjesë e pazbuluar e trashëgimisë sonë kulturore gjendet nën fundin e detit apo të Liqenit të Shasit. Në bashkëpunim me grupet e njohur botërisht të arkeologjisë nënujore, do të studiohen këto lokaliteti dhe planifikohet mbrojtja e kësaj pasurie qoftë nën ujë qoftë edhe në muze.

FORCA do të stimulojë edhe jetën kulturore në qytet në formë të qëndrueshme duke stimuluar artistët për krijimtari të vazhdueshme qoftë me infrastrukturë, qoftë edhe me mjete materiale e kontakte. Në veçanti, do të themelohet një galeri artesh, do të re konstruktohet Kino Salla në Ulqin dhe kthyer këtë lokalitet të rëndësishëm historik e kulturor të qytetit në një kinema dhe teatër për nevojat e qytetit. Edhe Katërkolla duhet të pajiset me një hapësirë multifunksionale multikulturore ku të përfshihet një bibliotekë publike me emrin Basri Ccabriqi.

Kujdesi i Komunës ndaj kësaj fushe, përveç se me reorganizimin e Qendrës për Kulturë, do të jetë i institucionalizuar edhe me buxhet edhe me Sekretariatën për Arsim dhe Kulturë i cili do të orkestrojë ekzekutimin e këtij programi.

Valdanosi, Kriporja dhe parqet

Çështja e Valdanosit është në proces i cili po ndiqet me vëmendje deri në kthimin e ullishtës pronarëve. FORCA i ka paraprirë mbrojtjes së këtij lokaliteti unik në Mesdhe dhe në këtë, së bashku me ish-pronarët dhe dashamirësit e tjerë ka arritur që ky lokalitet të mbesë zonë e mbrojtur nga ndërtimet. Komuna do të asistojë revitalizimin e kësaj ullishte.

Me këtë nuk mbaron detyra jonë. Ne duam ta revitalizojmë infrastrukturën e rekreacionit në këtë lokalitet, vendosim ndriçim dhe studiojmë instalimin e mbrojtjes nga zjarri. Projekti i revitalizimit të rrugëve të Valdanosit që do të mundësojnë intervenime në raste zjarri dhe emergjence është i gatshëm dhe pret ekzekutimin.

Në bashkëpunim me Ndërmarrjen Publike “Parqet Nacionale” vizita e Kripores do të futet në produktet turistike të qytetit. Për këtë, do të krijohet edhe një plan për vendosjen e një lidhje transporti në mes të qytetit dhe Kripores, që Kriporja të pajiset me stola dhe pajisje të tjera për rekreacion e pushim.

Shëndetësia

FORCA i mbetet besnike zotimit për rritjen e kualitetit të shërbimeve mjekësore që ofrohen nga shërbimi i rregullt mjekësor dhe nga shërbimi i urgjencës. Në veçanti, gjatë sezonit veror Komuna do të insistojë në hapjen e disa pikave të ambulante të Shërbimit të Urgjencës ku veturat e ambulancës gjejnë vështirësi për të depërtuar, si për shembull në Ranë dhe në Shtoj. Një vëmendje e veçantë do t'i kushtohet shtrirjes së shërbimeve të mjekësisë primare dhe emergjente në Anë të Malit dhe Krajë.

Si parti nacionale, kemi obligim të veçantë që të gjejmë mundësitë dhe mënyrat që shqiptarët të kenë shërbime edhe specialiste dhe spitalore në Mal të Zi pa pengesa dhe vonesa. Krahas këtyre, Komuna e Ulqinit do të kujdeset për gjendjen shëndetësore të qytetarëve duke shkëmbyer statistikën rreth problemeve shëndetësore të qytetarëve të Ulqinit me Shtëpinë e Shëndetit të Ulqinit dhe Institutin për Shëndetësi Publike. Më tej, do të ndiqen rekomandimet profesionale bashkëkohore për menaxhimin e këtyre problemeve dhe parandalimin e problemeve shëndetësore.

Materniteti i Ulqinit duhet kompletuar me sallë operacioni dhe me stafin përcjellës. Komuna e Ulqinit i ka kushtuar kujdes të veçantë nevojave të qytetarëve me aftësi të kufizuar dhe për këtë FORCA ka ndjeshmëri të veçantë për nevojat specifike të kësaj kategorie.

Kalaja

Kalaja është një nga dokumentet e gjalla më të vjetër të qenies shqiptare në Ulqin. Përveç që kompleksi muzeor do të revitalizohet dhe përmbajtja dhe veprimtaria e tij do të zgjerohen, Forca ka vënë themelet e rimëkëmbjes së infrastrukturës së gjithanshme të Kalasë me qëllim që jeta dhe veprimtaria brenda saj të jetë dinjitoze. Së shpejti fillojnë punimet në shtrimin e rrugëve të Kalasë. Përveç kësaj, në bashkëpunim me banorët e Kalasë, do të krijohet një plan për valorizimin e Kalasë për turistët, pa prishur qetësinë dhe funksionimin normal të jetës së banorëve. Nga aspekti i infrastrukturës, do të hapet edhe parkimi dhe mundësia për ardhjen e autobusëve të përmasave përkatëse që mund të mbërrijnë deri aty. Një kujdes i jashtëzakonshëm do t'i kushtohet edhe meremetimit të mureve veriorë të Kalasë që janë zbuluar nga pakujdesia e punimeve që janë bërë në të kaluarën aty.

Shasi

Mu sikur që e ka krijuar natyra dhe siç shfaqet nëpër hartat e vjetra, Shasi duhet të jetë i lidhur me Lumin Buna. Kjo do të bëhet duke e mirëmbajtur kanalën lidhëz dhe kontrolluar lëvizjen e ujit pa prishur biodiversitetin dhe rregullimin e rrjedhjes së ujërave. Komuna do të angazhohet që ta shndrojë shasin në një qendër të agroturizmit, të turizmit ekologjik dhe të turizmit kulturor duke organizuar aktivitete të shumta dhe duke e promovuar brenda dhe jashtë vendit.

Përveç ringjalljes së ekonomisë në këtë vend, studimi arkeologjik i tij duhet të vazhdojë së bashku me valorizimin turistik të këtij lokaliteti të rëndësishëm natyror dhe arkeologjik.

Infrastruktura komunale

Forca e Re Demokratike është e prirur që të ofrojë zgjidhje afatgjate dhe profesionale. Infrastruktura urbane në Ulqin është e vjetër dhe kërkon ndërhyrje rrënjësore dhe investime të mëdha. Mirëpo, Forca do të jetë përherë në shërbim të zhvillimit të ekonomisë së qytetarëve tanë dhe për këtë do të krijojme „sistemin 48” që është një sistem komunikimi i drejtpërdrejtë i qytetarit dhe Komunës lidhur me problemet në infrastrukturë, me ç ‘rast Komuna zotohet që të japë përgjigje në afatin prej 48 orësh.

Komuna do të përkujdeset që infrastruktura që shërben ekonominë e qytetit e në veçanti turizmin të jetë në nivelin më të lartë dhe që ikjen e rrymës elektrike dhe ujit gjatë sezonit turistik të jenë pjesë e historisë. Investimet në këtë fushë përherë do të jenë të prirura nga parimi i funksionalitetit dhe estetikës dhe në shërbim të rimëkëmbjes urbane në tërë Komunën e Ulqinit.

Një kujdes të veçantë për të ardhmen do të jetë aplikimi i parimit „dig once” (gërmo vetëm një herë), me të cilin do të sigurojmë që infrastruktura e nëndheshme instalohet në atë në mënyrë që nuk do të ketë më nevojë të thyhet asfalti për çdo intervenim apo kyçje në rrjetin e ujësjellësit, kanalizimit, rrymës apo telefonit.

Aprovimi i Planit Hapësinor është një arritje e lakmueshme për Forcën e Re dhe për këtë, në vazhdim ajo do të punojë denjësisht në implementimin e tij. Pjesët e këtij plani që planifikohen të realizohen në këtë periudhë katërvjeçare janë:

1. Zgjerimi i rrugës magjistrale Ulqin- Bunë,
2. Realizimi i pikës kufitare në Shën Koll
3. Valorizimi i zonave të parapara për turizëm gjegjësisht ndërtimi i komplekseve turistike duke animuar investitorë të vendit dhe të huaj.
4. Ruajtja dhe valorizimi i kripores si zonë e mbrojtur dha pa ndërtime duke synuar zhvillimin e prodhimtarisë së kripores si zgjidhje e vetme për ruajtjen e ekosistemit.
5. Në zonën e Krythës së Katërkollës Plani parasheh një zonë industriale me një pozicion të fortë strategjik që lidh Krujën, Ulqinin, Shkodrën e Tivarin me Ulqinin. Forca e Re Demokratike synon të krijojë kushte të favorshme që kjo zonë industriale të jetësohet në realitet duke tërhequr investitorë për ndërtimin e një pike grumbullimi bujqësor dhe fabrika të industrisë ushqimore, artizanale dhe të tjera.

6. Aprovimi i Planit Hapësinor hap rrugën e realizimit të projektit të hapjes së rrugës Pinjesh- Gjerana. Ky projekt do të mundësojë që edhe kjo zonë e qytetit të valorizohet. Me vazhdimin e administrimit të pushtetit lokal Forca e Re Demokratike do të angazhohet në aprovimin e dokumenteve të nevojshme për legalizimin e lehtë të objekteve të ndërtuara pa leje përpara miratimit të Planit. Të ardhurat nga vjelja e mjeteve për legalizimin e objekteve të ndërtuara pa leje do të përdoren për të investuar në infrastrukturën e përbashkët të zonave të reja.
7. Porto Milena do të vazhdojë të jetë një nga prioritetet e Forcës së Re Demokratike. Drejt zgjidhjes së këtij problemi Forca parasheh pastrimin e Porto Milenës dhe hapjen e kanalit që lidh lumin Buna me të me qëllimin fundor që Porti të jetë i lundrueshëm. Porti duhet të bëhet një atraksion për zhvillimin e turizmit elitare në këtë zonë.
8. Zgjidhja e problemit të Porto Milenës shkon dorë-për-dorë me realizimi e projektit të grumbullimit dhe sistemimit të ujërave të zeza dhe ujërave atmosferikë në katër zonat e qytetit: Batice, Mali i Bardhë, Kodra dhe Totosh. Kjo njëherazi do të jetë faza e parë e zgjidhjes së problemit shumëvjeçare të qytetit. Faza e dytë e këtij projekti është realizimi i fabrikës –impianit për pastrimin e ujërave të zeza. Forca e Re Demokratike në vazhdimësi është angazhuar në përmirësimin e furnizimit me ujë të pijshëm në territorin e komunës së Ulqinit përmes përpilimit të dokumentacionit teknik për realizimin e projektit . Projekt që planifikohet të realizohet në bashkëpunim me bankën gjermane për zhvillim KFË.
9. Forca e Re Demokratike do të angazhohet në përmirësimin e vazhdueshëm të ndriçimit publik në zonën e qytetit dhe rrethinë. Disa prej projekteve që do të jenë në shërbim të turizmit e që synojmë t'i realizojmë janë: ndriçimi publik i aksit rrugor Shtoj-Adë, ndriçimi i aksit rrugor deri në Valdanos, ndriçimi publik Katërkollë- Krythë dhe ndriçimi publik i tunelit Qafa në Krruç të Ulqinit. Për ta mbajtur hapin me kohën, do të tentojmë që ndriçimi i instaluar të jetë me llamba LED, me çka do të ulim kostot e energjisë dhe mirëmbajtjes.
10. Forca e Re Demokratike pikësynim të veçantë ka edhe zgjidhjen e problemit të trafikut të ngjeshur gjatë sezonit turistik. Kështu implementimi i vendimit të aprovuar për formimin e shërbimit të parkimit, ndërtimi i garazheve nën Kala, në Fushën e Ulqinit dhe pranë gjimnazit duhet të japin rezultatet e duhura në zgjidhjen e këtij problemi.

Në mandatin e ardhshëm katërvjeçar prioritet i qeverisjes sonë do të jetë sigurimi i përkrahjes nga fondet IPA, Bankës Islamike për Zhvillim, Agjencisë Turke për Investime TIKa, dhe Bankës Botërore për realizimin e projekteve infrastrukturore në Komunën e Ulqinit, siç vijojnë:

1. Vazhdimi i realizimit të projektit Bulevardi Teuta. Faza e parë, rreth rrotullimi pranë Komunës është realizuar.
2. Ndërtimi i garazheve publike pranë qytetit të vjetër, pranë gjimnazit dhe në fushën e Ulqinit.
3. Zgjerimi i rrugës për Bunë dhe hapja e pikës kufitare në Shën Koll.
4. Vazhdimi i gjelbërimit të hapësirave të lira pranë bulevardeve dhe rrugëve të qytetit.
5. Rregullimi i trotuareve në rrugën e Kosovës, rrugën Mujo Ulqinaku, rrugën për Adë dhe rrugën Krythë-Katërkollë
6. Vazhdimi i rregullimit të trotuarit dhe gjelbërimit në rrugën Ali Riza Ulqinaku dhe Rrugën Ymer Prizreni.
7. Ndërtimi i infrastrukturës në Fushën e Ulqinit.
8. Restaurimi i monumenteve kulturore.
9. Rregullimi i infrastrukturës në zonën Mavrijan.
10. Rregullimi i kanaleve.
11. Rregullimi i infrastrukturës për zonën e qytetit.
12. Ndërtimi i infrastrukturës në zonën industriale në Krythë.
13. Ndërtimi i rreth-rrotullimit në hyrje të qytetit.
14. Rregullimi i Braticës, Porto Milenës dhe Bunës.
15. Ndërtimi i ndriçimit publik në lagjet e qytetit dhe zonat rurale.

Këto investime do të jenë një premisë reale e zhvillimit ekonomik të Ulqinit në fushën e turizmit, bujqësisë dhe si produkt final do të jetë krijimi i vendeve të lira të punës.

Deti dhe të mirat detare

Një ndër motivet kryesore të krijimit të FORCËS ka qenë kundërvënia padrejtësisë që është bërë me Të Mirat Detare në kurriz të qytetarëve të Komunës së Ulqinit. Padrejtësia dhe diskriminimi vihen re qartë tek zbatimi me dy standarde i ligjit, duke diskriminuar shqiptarët, ndërkohë që zbatimi është plotësisht ndryshe në komuna të tjera të bregdetit të Malit të Zi. Përpos kësaj, shqetësues është edhe fakti që ndryshe nga ajo që parashikon ligji, të Mirat Detare janë shndërruar në të Mira „kontinentale” duke kontrolluar dhe shfrytëzuar shumë më tepër territor se sa i takon.

Edhe pse arritjet në përmirësimin e infrastrukturës ligjore për ndryshimin e gjendjes në zonën brenda kufirit të të Mirave detare, të cilën e rregullojnë Ligji për të Mirat detare, Plani hapësinor me dedikim të posaçëm për të Mirat detare, Ligji për ndërtim dhe planifikim, Plani hapësinor me dedikim të posaçëm të Zonës bregdetare, në masën më të madhe varen prej mundësisë së ndikimit në politikat shtetërore, si pushtet lokal do ta përdorim mundësitë e ndikimit me angazhimin maksimal të kapaciteteve tona të dijes dhe ndikimit politik.

FORCA do të luftojë keq-menaxhimin e zonës së të Mirave Detare dhe do të luftojë që menaxhimi i të Mirave Detare të bëhet edhe nga pushteti lokal në Komunën e Ulqinit e jo vetëm nga niveli qendror.

Sa i përket kësaj çështjeje, falë angazhimit të FORCËS, projektligji i fundit për të Mirat Detare parasheh që vija e të Mirave Detare të jetë 6 metra, e jo “së paku 6 metra” siç ka qenë deri më tani. Gjithashtu, Forca do të vazhdojë me këmbëngulje të kërkojë trajtim të njëjtë si komunat tjera bregdetare dhe do të ndikojë në përmirësimin e dispozitave ligjore përmes ndikimit me amendamente në Parlamentin e Malit të Zi.

FORCA premtan që me vazhdimin e pushtetit në Komunën e Ulqinit do të përdorë çdo mjet legjitim që është në dorë të Komunës për t'i përdorur pasuritë natyrore në shërbim të banorëve. Ajo do të zbatojë modelet më të mira dhe më të suksesshme të administrimit të bregdetit që njihen dhe aplikohen në shtetet më të zhvilluara të BE që kanë dalje në Detin Mesdhe.

Për më tepër, FORCA vëren që mangësitë në menaxhimin e bregut të detit po ndikojnë negativisht jo vetëm në ekonominë e qytetarëve, por edhe në

shkathtësitë, aftësitë dhe qëndrimet e brezave të rinj. Për këtë, FORCA zotohet për të marrë hapat konkrete që Ulqini të pajiset me disa limane të sigurta për ankorimin e anijeve vendase dhe të mysafirëve. Nga këto porte, porti në Liman do të ketë peshën dhe rëndësi të madhe. Këto porte, jo vetëm që do t'ia lehtësojë qytetarëve tanë posedimin e një anije dhe rekreacionit dhe ekonomisë së peshkimit e turizmit, por do të hapë një treg të ri turistik, i cili fatkeqësisht deri më tani po e anashkalon bregdetin e Ulqinit dhe atë shqiptar në tërësi mu për shkak të mungesës së kësaj infrastrukture.

Arsimi

hemelet e një shoqërie të shëndoshë vendosen në familje, kurse muret mbajtëse i ndërton arsimi. FORCA i ka identifikuar problemet në arsim në Komunën e Ulqinit dhe për këtë zotohet që -- edhe pse arsimi nuk është kompetencë e vetëqeverisjes lokale -- nëpërmjet të partneritetit me Qeverinë e Malit të Zi dhe partnerëve ndërkombëtare të sigurojë që gjeneratat e reja të marrin arsim cilësor.

jëri nga problemet kyçe të arsimit është keq menaxhimi dhe punësimi jo transparent. Edhe pse në këto dy probleme vetëqeverisja lokale nuk mund të ndikojë në mënyrë të drejtpërdrejtë, FORCA do të jetë përkrahës i idesë që edhe në këtë sektor të ketë transparencë të plotë dhe të ketë menaxhim adekuat.

Komuna nën drejtimin e FORCËS do të jetë pro aktive në nxitjen e përmirësimit të infrastrukturës shkollore në qytet, në uljen e numrit të nxënësve nëpër klasa, në pajisjen e plotë dhe përdorimin e plotë të kabineteve të biologjisë, kimisë, fizikës dhe arsimit teknik; në pajisjen e sallave sportive të shkollave dhe kopshteve dhe me pajisjen e nxënësve me tekste adekuate mësimore. Kujdesin e vet për këtë fushë, FORCA do ta institucionalizojë brenda Komunës dhe, si edhe në fushat e tjera, do të merren roli i nxitësit aktiv e jo pritësit e monitoruesit pasiv me themelimin e Sekretariatit për Arsim dhe Kulturë.

FORCA zotohet të stimulojë aktivitetet jashtëshkollore: ekipe dhe veprimtari sportive, klube artistike, aktivitetet kulturore, konkurse, ekskursione e vizita dhe shkëmbim kuadrosh dhe nxënësish me shkollat brenda dhe jashtë vendit.

Në partneritet me grupet e interesit, do të identifikohen fushat me deficit të kuadrove të cilat do të stimulohen me bursa. Dokumenti strategjik që përcakton fushat deficitare dhe rregullat e përzgjedhjes së kandidatëve do të hartohet dhe plotësohet për çdo 3 vjet.

Përveç këtyre, FORCA është e vetëdijshme për rëndësinë e ekselencës dhe për këtë nxënësve më të mirë të viteve shkollore dhe studentëve më të mirë, si dhe atyre që kanë korrur sukses në gara dhe olimpiada shkencore, do t'u ofrohen bursa, dhurata dhe lehtësira të tjera.

Për të nxitur iniciativën brenda shkollave në territorin e Komunës, Komuna do të sigurojë një sasi fondesh të cilat do të ndahen për projektet të aplikuara nga shkollat, bile edhe nga vetë nxënësit. Ndarja e këtyre fondeve do të bëhet në formën standarde si në rastin e OJQ-ve dhe fondeve dedikuar sportit.

Pavarësisht nga sistemi shkollor publik, FORCA do të nxisë hapjen e disa qendrave krijuese ku njerëzit dhe në veçanti të rinjtë dhe shkollarët tanë, do të mund të mblidhen të mësojnë, krijojnë dhe t'i realizojnë idetë e tyre, të ndajnë njohuri, të punojnë në projekte, të studiojnë elektronikën, robotikën, punën me dru, artin, qepjen, prerjen me laser, kodimin, programimin për Android dhe iOS. Në mbështetje të zhvillimit të ekonomisë, bazuar në kërkesën e industrisë hoteliereje të Ulqinit, do të studiohet mundësia e hapjes së disa degëve të shkollës profesionale, gjithnjë duke u bazuar në modelin zviceran e austriak dhe në bashkëpunim me përfaqësuesit e këtyre dy shteteve në Mal të Zi. Programet e tilla në Shqipëri janë treguar jashtëzakonisht të suksesshëm dhe duhet studiuar mundësia që ky model të zbatohet edhe në Ulqin.

Sporti dhe rekreacioni

Gjatë 4-viteve të ardhshme sporti do të jetë tjetër prioritet i yni. Do të vazhdojmë me stimulimin e aktiviteteve sportive në qytet duke mbështetur drejtpërdrejtë dhe në mënyrë transparente klubet sportive në qytet dhe sportistët e talentuar. Gjithashtu, do të studiohet mundësia e mbështetjes së disa disiplinave sportive për të cilat qytetarët tanë kanë predispozita fizike (si për shembull notin e vaterpolo) ose kemi kushte shumë të favorshme si për shembull lundrimi me rrema në Bunë dhe Liqe të Shasit apo lundrimi me vela në det.

Gjithashtu, do të shtrihet infrastruktura rekreative në qytet duke studiuar mundësinë e hapjes së disa terreneve sportive rekreative në qytet dhe këndeve të lojërave për fëmijë. Ulqini është qyteti i vetëm në Mal të Zi i cili nuk e ka stadiumin e vet apo pishinë të mbyllur. Për këtë, Forca zotohet se në 4 vitet e ardhshme, në bashkëpunim me Federatën e Futbollit të Malit të Zi si dhe Ministrinë e Sportit- Komuna e Ulqinit të bëhet me stadiumin e vet dhe që edhe pishina olimpike të bëhet realitet.

Rinia

Mbrojtja e të ardhmes sonë nënkupton mbrojtjen e rinisë nga droga, alkoolizmi dhe bixhozi. Ky pikësynim do të arrihet me formimin e infrastrukturës për rekreacion e sport, me nxitjen e hapjes së qendrave rinore dhe mbështetjen e iniciativave rinore.

FORCA do angazhohet në promovimin e aktiviteteve si ditët e hapura të institucioneve për të rinjtë, apo takime periodike të drejtuesve të institucioneve lokale me të rinjtë për të ndihmuar në angazhimin dhe njohjen e të rinjve me qeverisjen dhe vendimmarrjen lokale në Komunën e Ulqinit (12 gushti - Dita Ndërkombëtare e Rinisë e caktuar nga Kombet e Bashkuara në vitin 1999).

Përfshirja e të rinjve në të gjitha bordet vendimmarrëse në nivel qendror e lokal, rritja e përgjegjësisë dhe llogaridhënies ndaj të rinjve, ndërgjegjësimi dhe edukimi i të rinjve mbi përfaqësimin dhe participimin politik .Biznesi rinor dhe vetëpunësimi nëpërmjet hapjes së njësive të informacionit që informojnë të rinjtë mbi taksat, legjislacionin për të bërë biznes dhe mundësitë e investimit në ekonomi; duke i njoftuar ata edhe për kreditë e buta.

Në veçanti do të stimulohet shkollimi në universitetet më të mira të botës dhe për këtë do të organizohen programe jashtëshkollore për përgatitjen e nxënësve për testet standarde SAT dhe TOEFL.

Gratë

Duke qenë se gratë përbëjnë gjysmën e popullsisë në Komunën e Ulqinit, trajtimi i problemeve që mbart kjo kategori sociale, merr një rëndësi të madhe. Prioritet i

FORCËS për vitet në vazhdim do të jetë nxitja e programeve të kualifikimit profesional, në ato profesione që i përshtaten profilit të një komune turistike dhe që iu jep mundësi grave të përfshihen në tregun e punës. Për këtë gjë do të bashkëpunojmë me shoqërinë civile dhe komunitetin e biznesit.

FORCA gjithashtu do të japë mbështetje totale për të gjitha projektet që veprojnë në Komunën e Ulqinit e që kanë për qëllim ofrimin e shërbimeve sociale, informimin e grave mbi fenomene sociale që prekin statusin e tyre, mbështetje ligjore falas apo çfarëdo aktiviteti që synon përmirësimin e gjendjes së tyre sociale. Po ashtu do t'iu japë mbështetje të veçantë atyre projekteve të OJQ-ve që synojnë nxitjen e pjesëmarrjes së grave në vendim-marrje dhe në aktivitete kulturore e sociale në Ulqin.

Vëmendje e veçantë për FORCËN do të marrë projekti i çerdheve për fëmijët, në mënyrë që gratë të kenë mundësi të bëjnë një jetë aktive shoqërore, ekonomike apo politike pa u shqetësuar për kujdesin për fëmijët. Në këtë mënyrë duke pasur çerdhet që përkujdesen për fëmijët, gratë në Ulqin do të jenë më të lira për të pasur një karrierë personale, për të vijuar studimet, për t'u punësuar apo për të hapur një biznes.

Të moshuarit

Të moshuarit janë një kategori sociale që do të gëzojë një përkujdesje të veçantë nga FORCA duke përdorur moton "Pleqëri Pa Vetmi". Të moshuarit në Ulqin shpesh e marginalizuar për shkak të kushteve ekonomike dhe problemeve të tjera sociale prandaj FORCA ka për qëllim që të kujdeset në mënyrë të posaçme për ta.

Në kuadër të investimeve, do të synohet krijimi i ambienteve të gjelbëruara që do të shërbejnë si mjedise shlodhese për të moshuarit. Do të ndjekim politika fiskale të diferencuara për ato biznese që ofrojnë shërbime të veçanta për të moshuarit si për shembull ata që ofrojnë kafe falas për të moshuarit.

Brenda mandati të ardhshëm, FORCA në krye të komunës së Ulqinit do të ndërtojë një qendër ditore për të moshuarit ku të gjejnë një ambient të rehatshëm e zbavitës e të mund të marrin shërbime shëndetësore e sociale. Në bashkëpunim me drejtorit e shkollave, shoqatave joqeveritare dhe grupe të rinjve do të

organizojmë grupet e vullnetarëve që do të ofrojnë shërbime utilitare për pleqtë e braktisur apo të sëmurë.

Diaspora

Në Ulqin thuhet se një Ulqin jeton në SHBA dhe në Evropë. Lidhja me këtë pjesë të popullatës ka qenë gjithmonë e fortë. Mu sikur qytetarët rezidentë edhe këta qytetarët tanë do të përfitojnë nga digjitalizimi dhe profesionalizimi i shërbimeve të administratës vendore.

Në veçanti, do të studiohet modeli i Fondit Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim dhe tentohet që ky model të implementohet në bashkëpunim me Komunën gjatë periudhës së investimeve të ardhshme, ashtu që vlera e kontributit të diasporës të jetë e qëndrueshme dhe transparente.

Do të tentohet që Ulqini të përshihet denjësisht dhe jo sa për sy e faqe në projektet dhe aktivitetet e Samitit të Diasporës.

Bashkëpunimi me shoqërinë civile

FORCA i mbetet besnike transparencës së plotë dhe për këtë rolit të shoqërisë civile do t'i kushtohet vëmendje e veçantë.

Do të identifikohen lëmenjtë dhe çështjet për zgjidhjen e të cilave kërkohet bashkëveprim me këtë sektor dhe Komuna do të ndajë një fond të veçantë buxhetor për të mbështetur realizimin e këtyre projekteve. Krahas kësaj, Komuna do të krijojë edhe një grup pune të veçantë që do të monitorojë realizimin e projekteve të mbështetura nga Komuna e Ulqinit.

Ndërmarrjet Publike

FORCA ka identifikuar problemet endemike të secilës ndërmarrje publike dhe me qëllim që këta të kryejnë me sukses detyrat për të cilat janë krijuar, FORCA

ka identifikuar metodologjinë dhe planin për transformimin e tyre në ndërmarrje funksionale. Krahas kësaj nevoje, transformimi i këtyre ndërmarrjeve është detyrim ligjor. NP Radio-televizioni i Ulqinit duhet të kalojë nëpër një proces të modernizimit të shërbimeve të veta dhe shtrirjes së audiencës nëpërmjet internetit dhe rrjeteve sociale.

NP Qendra për Kulturë gjithashtu duhet t'i nënshtrohet ristrukturimit të kujdesshëm në mënyrë që nga ajo të krijohen njësi funksionale të dedikuara për shërbime të caktuara ashtu që të mos pengojnë njëra tjetrën siç është rasti për momentin. Në veçanti, inventarizimi, katalogimi dhe valorizimi i trashëgimisë kulturore ligjërish mund të bëhet vetëm nëpërmjet të institucioneve muzeore. NP për Kultivimin e Egërsirave duhet të përfshijë gjuetinë edhe akuakulturën.

Ndërmarrjet publike duhet të mbikëqyren dhe të publikojnë raporte të punës 6 mujore në mënyrë transparente pranë Kuvendit Komunal (ku këshilltarët të diskutojnë arritjet dhe ngecjet e punës). Bordet drejtuese të ndërmarrjeve publike duhet të raportojnë dhe të jenë transparente për zhvillimet si pozitive, ashtu edhe negative të ndërmarrjeve dhe të emërohen njerëz profesional për të rritur efikasitetin e punës dhe për të pasur rezultate pozitive si në të hyra, ashtu edhe në performancë menaxheriale.

Administrata

Për të realizuar këto caqe që do të mbrojnë të ardhmen e Ulqinit, përveç burimeve njerëzore duhet edhe një organizim më efikas. Do të vazhdohet me digjitalizimin dhe automatizimin e proceseve të punës brenda administratës lokale dhe digjitalizimin e shërbimeve kundrejt qytetarit, si garanci e shërbimeve efikase dhe transparente.

Një kujdes i veçantë do t'i kushtohet menaxhimit të proceseve gjyqësore në të cilat Komuna e Ulqinit është pala e paditur. Tanimë është e qartë se një numër i konsiderueshëm e tyre ka ardhur si pasojë e punës jo transparente brenda Komunës dhe shpërdorimeve. Mirëpo proceset për probleme pronësore do të monitorohen me kujdes ashtu që të mbrojmë pronën e Komunës dhe pronën e qytetarëve.

Brenda Komunës, do të themelohet Shërbimi për Përkthim dhe Dokumentim, i cili do të institucionalizojë përdorimin e drejtë të gjuhës shqipe dhe dokumentimit të drejtë të rrjedhave të ngjarjeve në Komunën e Ulqinit. Gjithashtu, do të optimizohet numri dhe kompetencat e sekretariateve të Komunës në mënyrë që administrata komunale të jetë efikase dhe në shërbim të qytetarëve dhe detyrave që duhet të ushtrojë. Një kujdes i veçantë do t'i kushtohet krijimit të shërbimit të evidentimit dhe mbledhjes së taksave lokale.

Zyra e projekteve, e cila deri më tani ka pasur rezultate të lakmueshme do të avancohet edhe më tej për të rritur pjesëmarrjen e Ulqinit në projekte ndërkombëtare me qëllim të thithjes edhe të ekspertizës edhe të fondeve në shërbim të qytetarëve. Për më tepër, FORCA do të tentojë që të gjitha kioskat dhe të gjithë shitësit ambulante të misrit, kokoshkave etj. të kenë pamje dinjitoze të pikave të shitjes dhe të operojnë në mënyrë legale. Për këtë, shërbimet e projektimit të qytetit do të studiojnë dhe përcaktojnë pamjen vizuale, pozitat dhe infrastrukturën përcjellëse.

Për zbatimin e vlerave dhe nxitjen e standardeve etike, duhet të zhvillohen trajnime mbi etikën (trajnime për të punësuarit në administratë mbi çështjet etike për të informuar dhe rritur ndërgjegjësimin e tyre mbi proceset administrative-publike) rekrutime për nëpunësit/stafin administrativ për rritjen e njohurive mbi etikën dhe për të forcuar integritetin në administratën publike.